



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 30 tetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Rreptësisht konfidencial dhe *Ex Parte*

Vendim për autorizimin e redaktimeve të përkohshme

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39 (3) të Ligjit nr. 05/L-053 Për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullave 87(1), 105(1) dhe 108(1)(a)-(b) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën (“Vendimi i Konfirmimit”)² kundër Hashim Thaçit (“z. Thaçi”), Kadri Veselit (“z. Veseli”), Rexhep Selimit (“z. Selimi”) dhe Jakup Krasniqit (“z. Krasniqi”) (bashkërisht “të akuzuarit”) dhe nxori fletarrestimet dhe urdhrat përkatës të transferimeve për të akuzuarit.³ Më të njëjtën ditë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu autorizoi kontrollimin dhe sekuestrimin për të akuzuarit, vendin e arrestimit të tyre dhe banesat, zyrat dhe automjetet e të akuzuarve.⁴

2. Më 30 tetor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) parashtroi: (i) aktakuzën e rishikuar më tej (“Aktakuza e Konfirmuar”)⁵; dhe (ii) një version të redaktuar të Aktakuzës së Konfirmuar (“Aktakuza e Redaktuar”).⁶ Ai gjithashtu i

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për konfirmimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit* (“Vendimi i Konfirmimit”), 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-06, F00027, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra transferimi*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-8, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versionet e korigjuara të Shtojcave 7 dhe 8 u protokolluan më 28 tetor 2020, përkatësisht me numrat F00027/A07/COR dhe F00027/A08/COR.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00028, *Vendim për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit*, datë 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00029, *Vendim për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit*, datë 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00030, *Vendim për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit*, datë 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00031, *Vendim për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit*, datë 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i korigjuar i Vendimit për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit në lidhje me z. Krasniqi u protokollua më 28 tetor 2020 si F00031/COR.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00034/A01, *Aktakuza*, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00034/A02, *Aktakuza*, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake të autorizonte redaktime të caktuara të përkohshme në fletarrestimin, urdhrin e transferimit dhe vendimin për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit në lidhje me z. Krasniqi, si edhe shtyrjen e dorëzimit të Aktakuzës së redaktuar për të, ose, në mënyrë alternative, dorëzimin e një versioni të saj me redaktime të mëtejshme.⁷

II. PARASHTRIME

3. ZPS-ja parashtron se për arsye operative, hetimore dhe të sigurisë, ajo parashikon që operacionet e arrestimit dhe/ose kontrollimit dhe sekuestrimit të lidhura me z. Krasniqi do të kryhen të paktën një ditë përpara të akuzuarve të tjerë.⁸ Në këto rrethana, ZPS-ja pohon se nëse Aktakuza e Konfirmuar, ashtu si edhe fletarrestimi, urdhri i transferimit dhe vendimi për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit për z. Krasniqi i dorëzohen atij në formën e tyre aktuale, ekziston rreziku konkret që të akuzuarit e tjerë të vihen në dijeni të informacionit të përmendur në to, përfshirë edhe statusin e personave të akuzuar dhe detaje të akuzave të ngritura kundër tyre.⁹ Kjo, nga ana tjetër, do të gjenerojë rreziqe konkrete që të akuzuarit të arratisen, të pengojnë ecurinë e procesit penal, përfshirë me anë të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve dhe viktimave, ose të kryejnë krime të tjera¹⁰

4. Për këtë arsye, ZPS-ja i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të autorizojë ZPS-në dhe/ose Zyrën Administrative, sipas rastit, të redaktojë përkohësisht, deri në konfirmimin e arrestimit për të katër të akuzuarit: (i) identitetet e të akuzuarve të tjerë në fletarrestimin, urdhrin e transferimit dhe vendimin për kontrollimin dhe sekuestrimin në lidhje me z. Krasniqi; dhe (ii) në pjesën 'Paraqitje e shkurtër e fakteve'

⁷ KSC-BC-2020-06, F00034, *Parashtrimi i Aktakuzës së konfirmuar dhe kërkesave në lidhje me të ("Kërkesa")*, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁸ Kërkesa, para. 2.

⁹ Kërkesa, para. 2.

¹⁰ Kërkesa, para. 2.

ë fletarrestimit për z. Krasniqi.¹¹ Për më tepër, ZPS-ja kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake: (i) të autorizojë që Aktakuza e Redaktuar t'i dorëzohet z. Krasniqi vetëm pas konfirmimit të arrestimit të të gjithë të akuzuarve; ose (ii) të autorizojë ZPS-në të bëjë redaktime të mëtejshme në Aktakuzën e Konfirmuar ("Aktakuza e Redaktuar më tej")¹² dhe të urdhërojë që Aktakuza e Redaktuar më tej fillimisht t'i dorëzohet z. Krasniqi deri në konfirmimin e arrestimit të të katër të akuzuarve.¹³ Së fundi, ZPS-ja kërkon mundësinë e bërjes së redaktimeve të mëtejshme në Aktakuzën e Redaktuar para se ajo të bëhet publike, pas transferimit të të katër të akuzuarve në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe, në çdo rast, jo më vonë se paraqitja e tyre e parë.¹⁴

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Në bazë të nenit 39(11) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kur është e nevojshme mund të sigurojë mbrojtjen dhe privatësinë e viktimave dhe dëshmitarëve, ruajtjen e provave, mbrojtjen e personave dhe informacionit të sigurisë kombëtare.
6. Në bazë të rregullës 87(1) të Rregullores, pas konfirmimit të aktakuzës, pa vonesë të papërligjur, Administratori i dorëzon personalisht aktakuzën të akuzuarit. Administratori i dorëzon të akuzuarit një kopje të legalizuar të aktakuzës, si edhe një përkthim të aktakuzës në një gjuhë që i akuzuari kupton dhe flet
7. Në bazë të rregullës 88(2) të Rregullores, aktakuza bëhet publike me redaktimet e nevojshme, jo më vonë se paraqitja e parë e të akuzuarit.
8. Në bazë të rregullës 105(1) të Rregullores, në rrethana të veçanta, palët mund t'i bëjnë kërkesë trupit gjykues për mosnxjerrjen e përkohshme të identitetit të një

¹¹ Kërkesa, para. 3(a).

¹² KSC-BC-2020-06, F00034/A03, *Aktakuza*, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹³ Kërkesa, para. 3(b)-(c).

¹⁴ Kërkesa, para. 5.

dëshmitari ose viktime pjesëmarrëse në procesin gjyqësor, që është në rrezik, deri sa të urdhërohen masat e përshtatshme mbrojtëse.

9. Në bazë të rregullës 108(1) së Rregullores, kur informacioni nën ruajtjen, kontrollin ose në dijeninë faktike të Prokurorit të Specializuar duhet nxjerrë, por kur një gjë e tillë mund, *ndër të tjera*, të cenojë hetimet aktuale, ose hetimet e ardhshme, ose të shkaktojë rrezik të rëndë për sigurinë e një dëshmitari, viktime pjesëmarrëse në proces, ose anëtarëve të familjeve të tyre, Prokurori i Specializuar mund t'i bëjë trupit gjykues kërkesë konfidenciale dhe *ex parte* për mosnxjerrjen e informacionit përkatës, në tërësi ose pjesërisht.

IV. DISKUTIM

A. REDAKTIMET E IDENTITETEVE TË TË BASHKAKUZUARVE DHE “VEPRAT PENALE DHE PARAQITJE E SHKURTËR E FAKTEVE”

10. Në lidhje me kërkesën e ZPS-së për redaktime të përkohshme në fletarrestimin, urdhrin e transferimit dhe vendimin për kontrollim dhe sekuestrim të lidhura me z. Krasniqi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton konstatimet se: (i) ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston rreziku i arratisjes për secilin prej të akuzuarve, pengimit të ecurisë së procesit penal, përfshirë me anë të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve, viktimave, ose bashkëkryesve, ose kryerjes së krimeve të tjera;¹⁵ dhe (ii) ZPS-ja ka demonstruar arsye bindëse që justifikojnë mosnxjerrjen e përkohshme të Aktakuzës së Konfirmuar dhe dokumenteve lidhur me të.¹⁶ Duke shqyrtuar më tej parashtrimet e ZPS-së se arrestimi dhe/ose operacionet e kontrollimit dhe sekuestrimit të lidhura me z. Krasniqi do të kryhen të paktën një ditë para të të akuzuarve të tjerë,¹⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se dorëzimi në formë të paredaktuar i fletarrestimit, urdhrin të transferimit dhe vendimit për kontrollim dhe sekuestrimin e

¹⁵ Vendimi për arrestimet dhe transferimet, para. 31, 35, 39, 43.

¹⁶ Vendimi i konfirmimit, para. 517.

¹⁷ Kërkesa, para. 2.

lidhur me z. Krasniqi te ai menjëherë pas arrestimit përbën rrezik konkret se të akuzuarit e tjerë do të vihen në dijeni të akuzave kundër tyre dhe të hollësive të tyre, gjë e cila, nga ana e saj, përbën rrezik konkret se ata mund të arratisen, pengojnë ecurinë e procesit penal, përfshirë me anë të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve, viktimave, ose bashkëkryesve, ose kryejnë krime të tjera. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren më tej se redaktimet e propozuara janë të kufizuara në fushëveprim¹⁸ dhe se versionet e paredaktuara të secilit prej të tri dokumenteve do t'i jepen z. Krasniqi pas konfirmimit të arrestimit të të tre të akuzuarve të tjerë.¹⁹ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se redaktimet e përkohshme të propozuara janë si të domosdoshme, ashtu edhe proporcionale.

B. DORËZIMI I AKTAKUZËS SË KONFIRMUAR

11. Në lidhje me kërkesën e ZPS-së për shtyrjen e dorëzimit të Aktakuzës së Redaktuar për z. Krasniqi ose, në mënyrë alternative, dorëzimin e Aktakuzës së Redaktuar më tej deri në konfirmimin e arrestimit për të katër të akuzuarit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se, në bazë të rregullës 87(1) të Rregullores, aktakuza i dorëzohet të akuzuarit pas konfirmimit të aktakuzës, pa vonesë të papërligjur. Sidoqoftë dhe duke marrë parasysh konstatimet e lartpërmendura të lidhura me rreziqet konkrete që dalin nga nxjerrja për z. Krasniqi të identiteteve të të akuzuarve të tjerë në pritje të arrestimit të tyre, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të përshtatshme që z. Krasniqi të marrë menjëherë pas arrestimit të tij Aktakuzën e Redaktuar më tej, siç propozohet nga ZPS-ja. Pas konfirmimit të arrestimit të të katër të akuzuarve, Administratorja do t'i dorëzojë personalisht Aktakuzën e Redaktuar z. Krasniqi.

¹⁸ Kërkesa, para. 3(a) dhe poshtëshënimi 10.

¹⁹ Kërkesa, poshtëshënimi 11.

C. VERSIONI I REDAKTUAR PUBLIK I AKTAKUZËS SË KONFIRMUAR

12. Në lidhje me kërkesën e ZPS-së për mundësinë për të bërë redaktime të mëtejshme në Aktakuzën e Redaktuar para nxjerrjes së saj për publikun, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton rregullën 88(2) të Rregullores dhe në këto rrethana e urdhëron ZPS-në të parashtojë një version të redaktuar më tej të Aktakuzës së Konfirmuar për qëllim të bërjes së saj publike, jo më vonë se paraqitja e parë e cilitdo prej të akuzuarve.

V. VENDIM

13. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **AUTORIZON** ZPS-në dhe/ose Administratoren, sipas rastit, të redaktojë përkohësisht, deri në konfirmimin e arrestimit të të katër të akuzuarve: (i) referencat për z. Thaçi, z. Veseli, dhe z. Selimi në fletarrestimin, urdhrin e transferimit dhe vendimin për kontrollimin dhe sekuestrimin për z. Krasniqi; dhe (ii) në Pjesën “Veprat penale dhe paraqitje e shkurtër e fakteve” në fletarrestimin për z. Krasniqi;
- b. **AUTORIZON** ZPS-në të bëjë redaktimet në Aktakuzën e Redaktuar më tej për t’ia dorëzuar z. Krasniqi;
- c. **URDHËRON** Administratoren t’i dorëzojë Aktakuzën e Redaktuar më tej z. Krasniqi menjëherë pas arrestimit të tij;
- d. **URDHËRON** Administratoren t’i dorëzojë Aktakuzën e Redaktuar z. Krasniqi menjëherë pas konfirmimit të arrestimit të të katër të akuzuarve; dhe
- e. **URDHËRON** ZPS-në të parashtojë një version të redaktuar më tej të Aktakuzës së Konfirmuar për qëllim të bërjes së saj publike jo më vonë se paraqitja e parë e cilitdo prej të akuzuarve.

_____/nëshkrim/_____

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E premte, 30 tetor 2020

Në Hagë, Holandë.